



**KOMUNA E KLINËS**

**DREJTORIA E ARSIMIT**

04 Nr. M1-267 2015

Datë : 19.04 2015

Drejtoria Komunaie e Arsimit në Klinë, mbështetur në Ligjin e Punës nr.03/L -212, neni 8, pika 1 dhe në Ligjin nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, neni 5, pika d,si dhe në Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr.8/ 2014, datë 25.02.2014, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, publikon :

**K O N K U R S**

Për plotësimin e vendit të punës drejtor në institucione edukativo-arsimore të Komunës së Klinës

- 1.Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “ Tre Dëshmorët “ Jashanicë
- 2.Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “ Nënë Tereza “ Budisalc
- 3.Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “ Dëshmorët “ Volljak
- 4.Shkolla fillore dhe e mesme e ulët “ Dëshmorët e Kombit “ Çabiq

**Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs:**

1.Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e drejtorit / zëvendësdrejtorit duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- 1.1 Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- 1.2 Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor ( së paku kualifikimin prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit universitar ) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimehdhënësit sipas Udhëzimit për licensimin e mësimehdhënësve dhe normativin mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tejtër ligjore;
- 1.3 Të kenë licensë të rregullt të mësimehdhënësit ose të jenë në procedurë të licensimit.
2. Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim.
- 3.Të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.
4. Të posedojnë këto dokumente:
  - 4.1 Certifikatën e lindjes;
  - 4.2 Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;

4.3 Dëshminë për përvojën e punës;

4.4 Portfolion profesionale ( Shih Shtojcën G);

4.5 Letërreferencë nga një institucion publik- kredibil ( si Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë );

4.6 Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake;

4.7 Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuese ku ka konkurruar ( së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12; Ariel) sipas udhëzimeve të MASHT-it;

4.8 Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;

4.9 Dëshminë se nuk është nën hetime.

#### **Detyrat e punës :**

Të planifikojë, të bashkërenditë dhe të menaxhojë punën në shkollë, sipas dispozitave dhe përgjegjësi që dalin nga ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Merr vendime të ndryshme lidhur me funksionimin normal të punës në shkollë. Bashkëpunon me DKA-në, me MASHT-in si dhe zbaton instruksionet dhe urdhëresat administrative të tyre të mbështetura në legjislacionin për arsimin.

#### **Kohëzgjatja:**

Themelimi i marrdhënies së punës bëhet nëpërmjet Kontratës, në pajtim me Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, për një periudhë katërvjeçare, duke përfshirë edhe kohën provuese tremujore. Në tekstin e Kontratës përfshihet edhe shuma e pagës mujore, të drejtat dhe obligimet.

#### **Konkurrimi dhe dokumentacioni**

Afati i konkurrit është 15 ditë nga data e publikimit të konkursit në njërin nga gazetat ditore që botohen në Republikën e Kosovës. Për vendin dhe kohën e intervistës kandidatët do të informohen me kohë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të shqyrtohen. Dokumentacioni për konkurrim dorëzohet në zyrën e shërbimit të DKA-së në Klinë. Dokumentet e aplikimit nuk kthehen



**DREJTORI**

Hajdin Morina